

POROSITES

**BASHKIA DURRËS  
L.1, SHESHI LIRIA**



KRYETAR

**EMIRIANA SAKO**

PROJEKTUES

**ERALD-G Sh.p.k  
Ing. Gëzim Islami**

ADMINISTRATOR & DREJTUES TEKNIK  
SHOQËRIA "ERALD-G" SHPK

ADRESA: RRUGA KOLI BANO  
PALLATI 26/1, AP. 4  
CEL: + 355 68 20 90 392  
e-mail: eraldgshpk@yahoo.com



CONSULENZA PROGETTO STRUTTURE



**STONE: MANAGEMENT & SERVICE s.s.**  
Professional Group

Via Cariona 201 - piano 1°  
54033 Carrara (MS) - ITALY  
Tel. +39 0585 623366  
e-mail hofmans@stoneinspector.com - www.stoneinspector.com

KONSULENCA  
**ARCHEA ASSOCIATI s.r.l.**  
**ARCHEA ASSOCIATI s.r.l.**

Via della Fornace 34/5

OBJEKTI: 50125 Firenze  
p iva 05173063483

VENDI

DURRËS - SHQIPËRI

'PROJEKT ZBATIMI I SHESHIT PUBLIK PARA HYRJES SE PORTIT'

'PROGETTO ESECUTIVO DELLA PIAZZA DEL PORTO'

# STP71\_00.01.0

Relazione tecnico descrittiva  
**RELACIONI TEKNIK**

PRINTOUT

**STRUCTURAL DESIGN / PROJEKTI I STRUKTURAVE**

REVIZIONI	DATE	PERSHKRIMI
0	15/06/2020	FIRST EMISSION
A		
B		
C		
D		

DATE

15/06/2020



From the desk of: **Stefano HOFFMANN** cell. phone +39 335 8026484  
Via email:

e enjte, 21 Maj 2020

1

Për:

Nga:

**Tenda # Durrës**

Veshja e jashtme nga panele të lehtësuar guri

<b><u>Raport i përshkrimit teknik</u></b>		Numri progresiv : <b>01_2020: rev.00</b>
Kategoria : Raport teknik	Java : 21/2020	Dorëzuar 21 Maj 2020 Nga: SH

**Përmbajtja**

<b>Përshkrim i përgjithshëm.....</b>	<b>2</b>
Panelet e veshjes.....	3
Kornizat primare (P1).....	4
Struktura dytesore (P2).....	4
Lidhjet.....	5
Instalimi.....	6
<b>Fundi i RAPORTIT.....</b>	<b>6</b>





## Përshkrim i përgjithshëm

Pjesa aktuale e projektit "LE VELIERE # DURRES" përkon me realizimin e një tavani te lakuar, i cili qëndron pezull, duke mbuluar një sipërfaqe prej rreth 1900 m<sup>2</sup>. Për të arritur rezultatin, është hartuar një sistem i cili konsiston në krijimin e një sipërfaqeje të realizuar nga mermeri natyror Bianco Carrara: adaptimi i gurit natyror ka kërkuar një dizajn specifik në mënyrë që të plotësojë kërkesat si të forcës ashtu edhe ndikimit të peshës së të gjithë përbërësve.

Sistemi i veshjes së tavanit është i përbërë nga elementët më poshtë:

### 1. Panelet e veshjes

Sipërfaqja përbëhet nga panele guri trekëndore të sheshtë, me madhësi të ndryshueshme të përshtatur sipas modelimit që ka sipërfaqja. Të gjitha panelet do të prodhohen nga panele të laminuara me peshë të lehtësuar, të prera sipas modelit të rrjetëzuar.

### 2. Kornizat primare (P1)

Të gjitha panelet individuale do të bashkohen paraprakisht në vend, në mënyrë që të krijojnë format trekëndore me përmasa më të mëdha, duke ruajtur ende një profil të sheshtë; bashkimi paraprak do të organizohet duke adoptuar korniza çeliku, të gjitha të montuara mekanikisht në vend në nivelin e tokës; këto korniza do të sigurojnë ngurtësinë siç kërkohet për elementë të tillë në fazën e trajtimit dhe instalimit.

### 3. Strukturat dytësore (P2)

Grupet e formuar të trekëndëshave mësiper, pasi të vendosen në nivelet e caktuara, do të ngrihen mekanikisht dhe do të fiksohen në një strukturë dytësore, e cila përbëhet nga tuba të fiksuara më parë në kapriatën strukturale kryesore.

Lëvizjet e dhura të nivelimit, do të mundësojnë rregullime të mëdha dhe të imëta, në mënyrë që forma e kërkuar e projektimit të mund të arrihet plotësisht.




Figura 1



## Panelet e veshjes

3

Panelet e veshjes do të realizohen nga panele të lehtësuar e të laminuar me faqe guri. Këto janë krijuar në mënyrë që të mbajnë peshën vetjake dhe ngarkesën e parashikuar nga era.

Gur natyral: BIANCO CARRARA (EN 12440)  
Funksioni: veshje e jashtme  
Trashësia tipike, 10 mm  
Sipërfaqja: rrjetë e hojzuar 120

Paneli mbështetës: panel i lehtësuar, strukturë alumini e hojzuar, madhësia mesatare e hojës 6.5 mm  
Funksioni: panel struktural  
Trashësia: 30 mm  
Struktura: alumin i hojzuar, Lidhje 3003 H19-H24  
Veshja e jashtme: fibër xhami tip E, rezin epokside bikomponente.

### Specifikime të produktit të mbaruar

- Finitura, e lëmuar dhe pa shkëlqim, rrjetë 120
- Përmasat nominale:
  - o Trashësia, e përgjithshme: 40 mm,  $\pm 1.0$  mm
  - o Trashësia, vetëm guri: 10 mm  $\pm 1.0$  mm
- Planariteti: paneli kompozit, gjatë lëvizjes së lirë, i nënshtrohet lakimit natyror si pasojë e kushteve të mjedisit, siç janë ndryshimet në temperaturë dhe / ose ndryshimet në lagështinë relative, pra sipas treguesve të dhënë, toleranca për planaritet  $\pm 10.0$  mm para fiksimit në kornizat parësore .
- Peshë totale e panelit kompozit:  $\approx 32$  kg/m<sup>2</sup>
- Forca elastike e sipërfaqeve të ngjitura:  $> 0.8$  N/mm<sup>2</sup>
- Pikat e fiksimit: GSH shufra të filetuara, M8\*25, inoks A4  
Ngarkesa në tërheqje:  $R_{kN} > 3.0$  kN




## Kornizat primare (P1)

Kornizat primare do të realizohen nga lidhje prej inoksi, të prera në gjatësinë e posaçme, të gjitha të montuara në vend për të realizuar grupet e formave të projektuara; të gjitha panelet përkatëse të veshjes duhet të fiksohen në këto të fundit, për t'ju nënshtruar më pas procesit të vendosjes në pozicionin përfundimtar. Lidhjet midis paneleve të bashkangjitur duhet të jenë 10 mm.

Materiali: inoks AISI 316 L

Gjeometria: seksion tubolar, i përkulur në të ftohtë, trashësia 3 mm, në gjatësinë e kërkuar

Sasia: rreth 6,400 lmt, ose 3,300 copa




## Struktura dytesore (P2)

Struktura dytesore do të prodhohet nga tuba inoksi, të drejtë, në gjatësi të përshtatshme, ku të gjitha seksionet do të jenë të fiksuara individualisht në kapriatat kryesore strukturore. Pas kontrolleve paraprake për pozicionimin e duhur, në to do të vendosen kornizat parësore dhe veshja. Fugatura midis kornizave të bashkangjitura duhet të jenë 10 mm. Pozicionimi i strukturës realizohet në vend, duke ndjekur indikacionet e pozicionimit sipas projektit.

Materiali: inoks AISI 316 L

Gjeometria: seksion tubolar, trashësia 3 mm, në gjatësinë e kërkuar

Sasia: rreth 2,000 lmt, ose 800 pjesë





Raste të veçanta: në disa raste specifike, kornizat parësore do të fiksohen direkt në kapriatat strukturore kryesore; kjo ndodh kryesisht në të katër vertekset, ku hapësira e mbetur midis veshjes dhe strukturave bëhet shumë e ngushtë.

## Lidhjet

Të tre nivelet e mësipërm do të lidhen me njëri-tjetrin me grupe nyjesh të ndryshme fiksimi, si në detajet e vizatimeve përkatëse.

Përgjithësisht:

Për panelet e veshjes duhet të përdoren nyje të veçanta inoksi, të fiksuara nga fabrika me materiale bikomponent, në përputhje me përshkrimin e prodhuesit.

- Llojet e shufravte të filetuara GSH M8\*25 (prodhuar në Itali)
- Pozicioni: në përputhje me vizatimet përkatëse

Të gjithë grupet e tjerë të nyjeve të fiksimit do të jenë vetëm mekanike, ato do të prodhohen dhe sistemohen në përputhje me vizatimet përkatëse.

- Materiali: inoks AISI 316 L
- Bullona dhe aksesorë: A4.70

FUNKSIONI	ELEMENTET	QTY	MATERIALI
Panele lidhës me kornizat primare (P1)	Nyja – N 5.1	9812	Inoks AISI 316L
Korniza lidhëse primare (P1) me strukturat dytësore (P2),	Nyja – N 2.1	1104	Inoks AISI 316L
Korniza lidhëse primare (P1) me strukturat dytësore (P2), lidhje fikse	Nyja – N 2.2	1120	Inoks AISI 316L
Struktura lidhëse dytësore (P2) me strukturat primare	Nyja – N 1.1	724	Inoks AISI 316L
Korniza lidhëse primare (P1) me strukturat primare	Të shumëfishta	≈ 200	Inoks AISI 316L



Sekuena e instalimit në sit do të jetë si më poshtë:

1. Vëzhgim topografik i kapriatave primare strukturale (QC).
2. Instalimi i strukturës dytësore (P2) me anë të lidhjeve specifike.
3. Kontroll i strukturës dytësore për saktësinë e niveleve (QC).
4. Në nivelin e tokës, grumbullimi i kornizave primare (P1) dhe panelet e caktuar të veshjes sipas zonave të caktuara.
5. Kontroll i çdo kornize primare për saktësinë e përmasave dhe planaritetit. (QC)
6. Ngritje e çdo kornize primare në pozicionin e saj specifik dhe fiksimi me elementët varës.
7. Përshtatje e niveleve të sipërfaqes së ekspozuar të veshjes me nivelin e vizatimeve të projektimit.
8. Kontrolli i niveleve të sipërfaqes së përfunduar për përshtatjen e saktë me nivelet e vizatimeve të projektimit (QC).
9. Shtrëngim i plotë i bullonave dhe pajisjeve shtesë anti-rrëshqitje në të gjitha lidhjet, të cilat i nënshtrohen forcave të fërkimit.
10. Sigurim i bashkimeve të nyjeve në pjesën e prapme (ana e sipërme) e paneleve të veshjes.
11. Pastrimi dhe përfundimi.

Cdo material dhe element do të shoqërohet nga një fletë e të dhënave specifike nga prodhuesi; një plan specifik cilësie do të përfshijë një plan provë për të kontrolluar karakteristikat aktuale të produkteve.

## Fundi i RAPORTIT

